



TV Men
Shukri Sylejmani
Drejtor

Ankesa Nr. 2012/56-KPM vs TV Men
Ref: 1210/889/KPM/as

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2012/56-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër TV Men ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Me datën 20 prill 2012 ka hyr në fuqi Ligji për Komisionin e Pavarur për Media Nr. 04/ L-044. Bazuar në këtë Ligji konkretisht në nenin 28, të gjitha shërbimet mediale audiovizuale janë të obliguara të paraqesin raport vjetorë në KPM, përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera të parapara me nenin 28 të Ligjit të KPM-së.
2. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me nenin 28 të Ligjit të KPM-së, ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar me nenin 28 të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojnë në pajtim me Ligjin e KPM-së duke mos e dorëzuar raportin vjetor brenda afatit të përcaktuar ligjor.
3. Duke u bazuar në shkeljen e Ligjit të KPM-së nga ana e Palës Përgjegjëse, më datën 4 maj 2012, KPM i ka dërguar Vërejtje me shkrim Palës Përgjegjëse, duke kërkuar që të veprojnë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin e KPM-së, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së, do të ndërmer masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
4. KPM edhe pas dërgimit të Vërejtjes, ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka dështuar vepror në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, duke mos sjellë raportin vjetor të paraparë më nenin 28 të Ligjit të KPM-së.

Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon së Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit të KPM-së.

Neni 28 i Ligjit të KPM-së përcakton:

"Shërbimet e licencuara mediale audiovizuale duhet t'i paraqesin raport vjetor KPM-së, në të cilin përfshihet informacioni përkitazi me programin dhe veprimin në

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera të parapara me ligj. Raportet vjetore duhet të dorëzohen në KPM-ë jo më larg se me datë 31 mars të vitit vijues, për vitin paraprak”.

6. Komisioni gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar të ndërmarrë hapa të nevojshme që të vie në pajtueshmëri me nenin 28 të Ligjit të KPM-së, pasi që ka dështuar të paraqes raportin vjetor ashtu siç parashihet me nenin 28 të Ligjit për KPM-në.
7. Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të Vërejtjes përmes së cilës i është bërë me dije se është në shkelje të nenit 28 të Ligjit të KPM-së ka vazhduar të mos respektojë Ligjin e KPM-së, duke mos sjell raportin vjetor ashtu siç parashihet me nenin 28 të Ligjit për KPM-në.
8. Komisioni bazohet në Udhëzimin për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të licencuarve i cili përveç tjerave thotë se KPM gjithmonë e ka parasysh natyrën proporcionale të sanksioneve. Sanksionet do të jenë proporcionale me natyrën dhe me seriozitetin e një shkeljeje dhe me shkallen ekonomike të te licencuarit, dhe nuk do të jenë më të rëndë se sa të nevojshme për të parandaluar shkelje tjera dhe për të inkurajuar veprime përmirësuese nga ana e të licencuarit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevant lehtësues apo rendues.
9. Komisioni duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon së Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 28 të Ligjit të KPM-së.

VENDIM

10. Bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Nenit 28 të Ligjit të KPM-së, pasi që ka dështuar të paraqes raportin vjetor ashtu siç parashihet me nenin 28 të Ligjit të KPM-së.
11. Komisioni bazuar në nenin 30 pika 1 të Ligjit të KPM-së, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptohet masa sanksionuese **Vërejtje** për shkeljen e nenit 28 të Ligjit të KPM-së.
12. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij vendimi vazhdon të veprojë në kundërshtim me Ligjin e KPM-së apo aktet nënligjore të KPM-së, Komisioni do të iniciojë procedura ligjore për ndërmarrjen e masave tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me Nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
13. Komisioni gjithashtu kërkon nga ana e Palës Përgjegjëse që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet të cilat bien ndesh me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.


E drejta për Ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42 paragrafi 2 të ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
16. Bordi për Ankesa mundet që pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërin nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në

pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pavlera keqdashëse apo të pabaza.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim


Shefki Ukaj

Kryetar

Komisioni i Pavarur për Media



04 tetor 2012
datë